



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 31.07.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIM I INSTITUTIT TË POLICISË SHKENCORE”, ME VENDNDODHJE NË
BASHKINË TIRANË”, ME ZHVILLUES DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtim i Institutit të Policisë Shkencore”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me zhvillues Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINIËS

MINISTËR I BRENDSHËM

ERVIN HOXHA




A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top and "MINISTRIA E BRENDSHMË" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania, featuring a double-headed eagle.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top and "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania, featuring a double-headed eagle.

Nënshkruar më datë 12 / 12 / 2024